UDHËZIM
Nr.1, datë 7.9.2005

PËR KRITERET E VEÇANTA TË MARRJES NË PUNË DHE DEKLARIMIN E PASURISË SË NËPUNËSVE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE

Mbështetur në nenin 102 të Kushtetutës pika 4 dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr.108, datë 11.2.2005 "Për mënyrën e organizimit, të funksionimit dhe pagat e punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave" pika 6, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Përcaktimi i kritereve të veçanta të punësimit për nëpunësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, ka për qëllim të sigurojnë një administratë, të aftë profesionalisht, të pavarur dhe me integritet të lartë moral, nëpërmjet procedurave transparente përzgjedhëse dhe të mbështetura në kritere tërësisht profesionale, për të përballuar detyrat e përcaktuara me ligj.

2. Nisur nga natyra e punës së Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), si qendër kombëtare e mbledhjes, administrimit, analizës së informacionit financiar, konfidencialitetit të këtij informacioni, identifikimit të zbulimeve dhe shkëmbimit të informacionit me struktura të tjera kompetente të zbatimit të ligjit brenda vendit dhe me homologë e partnerë ndërkombëtarë, personeli i Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, krahas kritereve të përgjithshme të punësimit, të përcaktuara në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", do të ketë të specifikuara dhe kritere të veçanta specifike sipas përcaktimeve të bëra në këtë udhëzim.

Kriteret e veçanta për punonjësit e DPPPP

3. Fitojnë të drejtën për të konkurruar në pozicionet e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, nëpunësit që krahas kritereve të përgjithshme të përcaktuara në ligjin "Statusi i nëpunësit civil", plotësojnë edhe kriteret e veçanta, të përcaktuara si më poshtë:

a) Të kenë mbaruar arsimin e lartë (sipas kritereve dhe përshkrimeve të punës për çdo pozicion).

b) Të kenë integritet të lartë moral.

c) Sipas certifikatës familjare, të mos jenë dhe të mos kenë anëtarë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen veprave penale.

ç) Të mos zhvillojnë aktivitete që janë në konflikt interesi dhe të mos kenë konflikt interesi me subjekte të ligjit "Për parandalimin e pastrimit të parave", të ndryshuar.

d) Të mos jenë marrë ndaj tyre masa disiplinore të largimit nga puna ose nga shërbimi civil.

dh) Të pranojnë dhe të deklarojnë menjëherë pas fillimit të punës dhe për çdo vit kalendarik në vazhdim, deklaratën e pasurisë.

e) Të deklarojnë se pranojnë vullnetarisht aplikimin e procedurave të verifikimit ndaj tyre.

f) Të deklarojnë ruajtjen e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror" dhe respektimin e kërkesave të ligjit "Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror".

g) Të mos jenë anëtarë të ndonjë force ose organizate me karakter etnik dhe nacionalist.

4. Kriteret specifike dhe përshkrimi i punës për çdo pozicion sipas strukturës së miratuar me urdhër të Kryeministrit nr.34, datë 16.3.2005 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave" janë ato të përcaktuara nga grupi i punës i ngritur në Drejtorinë e Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave.

5. Për informacion rreth pikave c, ç, d dhe g të nenit 3 të këtij udhëzimi bashkëpunohet me Ministrinë e Drejtësisë, Drejtorinë e Informacionit të Klasifikuar "Sekret shtetëror", Ministrinë e Rendit Publik, institucionet dhe ose qendrat e punës, të banimit, arsimimit të kandidatëve.

6. Nëpunësit e DPPPP-së, që nuk u nënshtrohen kërkesave të ligjit "Për deklarimin e pasurive financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", do të bëjnë deklarimin e pasurisë pranë sektorit të personelit të DPPPP-së, menjëherë sapo të fillojnë punë, dhe për çdo vit kalendarik në vazhdim, sipas formatit të përcaktuar nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.

7. Përgjegjësi i sektorit të personelit të DPPPP-së, informon të gjithë nëpunësit e DPPPP-së

për detyrimet që u lindin, lidhur me deklarimin e pasurisë, për respektimin e ligjit “Për rregullat e etikës në administratën publike” (si parimet e përgjithshme të etikës, konflikti i interesave dhe shmangia e tyre, veprimtaria e jashtme e nëpunësit, detyrimet e tjera gjatë dhe pas periudhës së punësimit), detyrimet që lindin nga ligji “Për trajtimin e informacionit të klasifikuar sekret shtetëror” dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Malaj